Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri

KOMENTET E KRYETARIT TË PREZENCËS PËR MEDIAT
PAS TAKIMIT ME PROKUROREN E PËRGJITHSHME
12 shtator 2012

Cili ishte qëllimi i takimit me znj. Ina Rama?

Ambasadori Wollfarth: "Unë takohem herë pas here me Prokuroren e Përgjithshme. Posti i saj është një pozicion kyç në sistemin e drejtësisë në Shqipëri. Diskutimet politike aktuale për imunitetin janë shumë të rëndësishme. Ato do të çojnë edhe drejt reformës së sistemit të drejtësisë, por ajo që mbetet një çështje e pandryshueshme dhe e rëndësishme në sistemin e drejtësisë është puna e një prokurori të përgjithshëm të pavarur. Dhe unë sapo u takova me prokurorin e përgjithshëm të pavarur. Pra, në këtë aspekt, një punë e pavarur në përgatitjen e rasteve për në gjykatë, ku merret vendimi, mbetet e rëndësishme për drejtësinë e çdo vendi, pra edhe për drejtësinë në Shqipëri".

Z. Ambasador, gjatë kohëve të fundit, ka pasur një debat lidhur me kohën kur përfundon mandati i Prokurores së Përgjithshme, zj. Ina Rama, për shkak të ndryshimeve kushtetuese që u realizuan pas marrëveshjes mes palëve. Në këndvështrimin tuaj, kur duhet të përfundojë mandati i Prokurores së Përgjithshme?

Ambasador Wollfarth: "Është e vërtetë që ka disa interpretime të ndryshme të mandatit sipas Kushtetutës. Fakt i rëndësishëm është që tashmë mandati i prokurorit të përgjithshëm është i kufizuar dhe jo i pakufizuar. Kështu që do të thosha që herët a vonë, apo më mirë, vonë a herët, do të hapet dritarja e mundësisë për të pasur një pasardhës në postin e prokurorit të përgjithshëm. Do të jetë shumë e rëndësishme që të përdoret kjo kohë, e cila mund të llogaritet më mirë në muaj se sa në javë, pra, të përdoret kjo kohë prej disa muajsh për të kërkuar një personalitet të kualifikuar që të jetë në gjendje të kryejë këtë detyrë sa kërkuese aq edhe, shpresoj edhe në të ardhmen, të pavarur. Në këtë pikë, unë do të doja, në formën e një komenti, të ftoja që të shfrytëzohen më së miri burimet e pasura të personaliteteve në këtë vend për të identifikuar persona të mirë që do të kualifikoheshin për këtë pozicion dhe ta mbanin këtë çështje larg periudhave më intensive politike, siç janë fushatat zgjedhore. Viti 2013 ka për të qenë, me siguri, një vit shumë i gjallë për shkak të zgjedhjeve të përgjithshme, por bazuar në faktin që ndryshimet kushtetuese hynë në fuqi në maj 2008, maji do të ishte një datë e mundshme për ndërrimin e prokurorit të përgjithshëm. Por kjo mbetet për t'u diskutuar. Lejoëni të përsëris se ajo që është më e rëndësishme është që të gjendet, të identifikohet dhe të përzgjidhet një personalitet i kualifikuar për të kryer si duhet këtë punë shumë kërkuese. Në këtë pikë, do të doja të shtoja që vazhdon të më bëjë përshtypje pozitive puna e znj. Ina Rama, si Prokurore e Përgjithshme e Shqipërisë. Ajo po e drejton dhe e ka drejtuar këtë zyrë në kohë sfiduese dhe i ka kushtuar gjithmonë shumë rëndësi faktit të të punuarit në mënyrë të pavarur, në dobi të drejtësisë në Shqipëri".

Z. Ambasador, Prokurorja e Përgjithshme shpeshherë është ankuar se ka ndërhyrje politike dhe kërcënime politike në çështje të caktuara, sidomos ajo e fundit e 21 Janarit. A e diskutuat këtë çështje me Prokuroren e Përgjithshme dhe a mendoni se ju si

insitucion dhe institucionet e tjera ndërkombëtare ankesave të Prokurores së Përgjithshme u jeni përgjigjur pak, nuk e keni ndihmuar atë në pavarësinë e saj?

Ambasadori Wollfarth: "Prokuroria e pavarur po punon për ngjarjet e 21 janarit. Në fakt, folëm shkurtimisht edhe për këtë çështje. Do të doja të shprehja një dëshirë, edhe në emër të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri: ekzistojnë mundësitë për ta mbështetur akoma më shumë punën e rëndësishme hetuese të prokurorit të përgjithshëm lidhur me këtë çështje, me të gjithë elementët që mund të ofrojë shteti i Shqipërisë. Deri tani, një pjesë e madhe e hetimeve janë kryer nga stafi i vetë Prokurores së Përgjithshme. Kësaj pune mund t'i shtoheshin përpjekje shtesë nga burime të tjera, përfshirë ministritë. Kjo do të përshpejtonte atë që unë do ta konsideroja një hetim shumë shumë të rëndësishëm".

Fund